

VENDIM
Nr.61, datë 27.9.2006

PËR EMËRIMIN E BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 34 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Elisabeta Gjoni (Semini) emërohet Kryetare e Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes financiare për 5 vjet.

II. Zoti Keler Gjika emërohet Nënkyetar i Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare dhe drejtues i Departamentit të Mbiqëqyrjes dhe disiplinimit për 5 vjet.

III. Zonja Ermela Guxholli emërohet Nënkyetare e Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare dhe drejtuese e Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit për 4 vjet.

IV. Zonja Miranda Ramaj emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për 5 vjet.

V. Zonja Diana Lamani emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për 4 vjet.

VI. Zonja Silvana Bello emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare për 3 vjet.

VII. Zonja Rajmonda Shaqiri emërohet anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbiqëqyrjes financiare për 3 vjet.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)